

## DEKLARATË E GRAVE DHE VAJZAVE TË KOMUNITETEVE RURALE

### Zvogëlimi i hendekut financiar gjinor: Rruga drejt një të ardhme me barazi gjinore

Ne, më shumë se 150 përfaqësuese nga komunitetet rurale të bashkive të Kolonjës, Elbasanit, Pukës, Malësisë së Madhe, Shkodrës, Pogradecit, Lushnjës, Beratit etj., u mbledhëm më 12 tetor 2023 në ambientet e Universitetit Bujqësor të Tiranës për të adresuar sfidat që përjetojnë gratë dhe vajzat në këto zona. Bashkë me përfaqësues nga Agjencia Italiane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, FAO, UN Women, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, institucione të tjera të qeverisjes qendrore dhe vendore, Universitetit Bujqësor të Tiranës, Rrjetit Shqiptar të Zhvillimit Rural, organizatave anëtare të ANRD si dhe organizata të tjera të shoqërisë civile, diskutuam rreth sfidave dhe prioriteteteve tona si dhe masat që duhet të ndërmerren për të përmirësuar mirëqenien tonë, veçanërisht qasjen në financa dhe sigurimet shoqërore si dhe përfshirjen tonë në proceset e vendimmarrjes.

*Ne, gratë dhe vajzat - jemi shtylla e familjeve dhe komuniteteve tona.* Kontributi ynë në sektorin e bujqësisë është i rëndësishëm në çdo hallkë të zinxhirit të vlerës, në ekonominë, familjet dhe komunitetet tona. Rreth 40% e totalit të femrave në Shqipëri janë të punësuara në sektorin e bujqësisë. Gratë në zonat rurale nuk janë thjeshtë “gratë e fermerëve”, por ato janë fermere, sipërmarrëse dhe drejtuese në komunitete vendore. Puna e tyre e palodhur është themeli i sigurisë ushqimore dhe zhvillimit të qëndrueshëm. **Sigurimi i mundësive të barabarta për gratë në zonat rurale nuk është vetëm çështje drejtësie, por është e vetmja mundësi për shfrytëzimin e plotë të potencialit të komuniteteve rurale.**

*Megjithatë, qasja e pabarabartë mbi të drejtën pronësore të tokës bujqësore, puna e papaguar, punësimi informal dhe stereotipat gjinorë kufizojnë aksesin tonë në kredi dhe investime, duke penguar zhvillimin, rritjen dhe formalizimin e bizneseve tona.* Pavarësisht se vajzat dhe gratë japin kontributin më të madh në sektor, vetëm 10% e tyre kanë aplikuar për kredi. Është alarmant fakti që shumica e grave në zonat rurale nuk kanë llogari bankare dhe as njohuritë bazë të financave personale, elementët themelorë të gjithëpërfshirjes financiare. Pjesa më e madhe e tyre ndihen të privuara nga burimet financiare për shkak se dokumenti mbi pronësinë e tokës apo pronës në përgjithësi është në emrin e bashkëshortëve dhe institucionet financiare nuk ofrojnë produkte të përshtatshme me nevojat e grave dhe vajzave në zonat rurale. Duke qenë se pronësia e tokës është zakonisht në emër të bashkëshortit apo babait, gratë dhe vajzat në zonat rurale përballen me pabarazi në pagesën e kontributeve – ato paguajnë kontribute duke përdorur pronën që nuk është në emrin e tyre. Kjo është mungesë e drejtësisë financiare. **Ky realitet reflekton nevojën për një përmirësim të përfshirjes financiare të grave dhe vajzave në zonat rurale, duke siguruar qasje të barabartë në burime, asete dhe informacion si dhe duke inkurajuar trajtimin e tyre si pjesëmarrëse kyçe në zhvillimin ekonomik vendor.**

*E tashmja dhe e ardhmja jonë është e kërcënuar nga pamundësia për të përfituar nga skemat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.* Kjo lidhet ngushtë me angazhimin tonë në punë të papaguar, punësimin informal dhe të drejtën pronësore mbi tokën. Ligji aktual na privon ne nga shërbimet jetike dhe shtetin, nga të ardhurat e mundshme. **Leja e lindjes për gratë është një mundësi e rëndësishme për qasje në shërbime të nevojshme për fëmijën dhe nënën pas lindjes.** Lehtësimi i vetësigurimit do të mundësonte gratë në zonat rurale të kenë akses në barrëlindje, duke ndihmuar gratë të përballojnë shpenzimet për fëmijën në vitin e parë të lindjes.

Mungesa e një këndvështrimi gjinor në këtë proces lë jashtë sistemit shumë gra të angazhuara në bujqësi dhe zhvillim rural. **Është e domosdoshme që të zhvillohen politika dhe masa që lehtësojnë qasjen tonë në këto shërbime të rëndësishme sociale dhe shëndetësore dhe njohja e punës tonë të papaguar, duke rishikuar legjislacionin që parashikon vetëpagesën për kontributet e sigurimit shoqëror dhe shëndetësor për personat e vetëpunësuar në bujqësi, veçanërisht për gratë dhe vajzat e angazhuara në bujqësi. Rishikimi dhe përmirësimi i politikave për të siguruar një mënyrë të drejtë dhe të barabartë për gratë në zonat rurale për të paguar kontribute dhe për të lehtësuar barrëlindjen janë prioritare.**

*Ne kemi vështirësi të përfshihemi në hallkat me vlerë të lartë në zinxhirin e vlerës dhe shpesh produktet e punës tonë përfundojnë si dhurata.* Vetëm 18% e bizneseve në zonat rurale drejtohen nga gratë. Ndërsa një pjesë e vogël e jona ka arritur të krijojë sipërmarrjen e vet me mund e sakrificë, kjo nuk është e mjaftueshme. Nevoja për masa dhe politika që mbështesin sipërmarrjen e grave në zonat rurale është e dukshme. **Është thelbësore që gratë në këto zona të kenë qasje të barabartë në njohuri dhe burime financiare, mbështetje në marketing dhe kapacitete magazinimi dhe marketimi për produktet e tyre duke kontribuar në zhvillimin ekonomik të komuniteteve të tyre.**

*Përfshirja jonë në vendimmarrjen vendore është e kufizuar, duke mos qenë në gjendje të shprehim nevojat tona, të cilat nuk pasqyrohen në programet dhe strategjitë zhvillimore.* Në nivelin e këshillave bashkiake, ku kuota e grave është 50%, vërehet një përqindje e ulët e grave. Ky përjashtim jo vetëm minon parimin e gjithëpërfshirjes, por gjithashtu e privon vendimmarrjen nga perspektivat dhe kontributet unike të grave. Pjesëmarrja e grave në proceset vendimmarrëse përkthehet në përmirësime të prekshme për të gjithë, sepse ato përcjellin sfidat dhe prioritetet me të cilat përballen në përditshmërinë.

*Ne i bëjmë thirrje qeverisjes vendore dhe qendrore të angazhohen në përmirësimin e aksesit për gratë dhe vajzat në zonat rurale në kredi dhe investime, duke eliminuar pengesat dhe diskriminimin gjinor në procesin e aplikimit.*

*Është e domosdoshme që qeveria të fokusohet në rishikimin e legjislacionit për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për personat e vetëpunësuar në bujqësi, për të lehtësuar sigurimin e grave dhe aksesin në përfitimet e barrëlindjes.*

*Ne kërkojmë politika dhe masa specifike që ndikojnë në rritjen e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në qeverisjen vendore.*

Në përfundim, ne shprehim gatishmërinë tonë për të vazhduar këtë dialog të rëndësishëm dhe bashkëpunim me autoritetet vendore dhe qendrore, si dhe me aktorët e interesuar në përmirësimin e mirëqenies së grave dhe vajzave në zonat rurale. Bashkë, mund të krijojmë një mjedis të barabartë dhe të drejtë për gratë, duke rritur qasjen e tyre në financa dhe sigurime shoqërore, si dhe duke rritur pjesëmarrjen e tyre në proceset vendimmarrëse.

Fuqizimi financiar dhe përfshirja në proceset e vendimmarrjes janë mjete të rëndësishme për zbutjen e pabarazive në komunitetet tona. Nevojitet të luftojmë pabarazitë gjinore për të fuqizuar gratë në zonat rurale, pasi **fuqizimi i grave është baza e zhvillimit të qëndrueshëm social dhe ekonomik të komuniteteve tona.**